



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS

Këshilli i Gjykatës

Nr 2166. .Prot.

Durrës, më datë 05.04.2024

SHPALLJE PËR LEVIZJE PARALELE DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN
CIVIL GJYQËSOR
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE “SPECIALIST BUXHETI”

Në mbështetje të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Vendimit nr 13 datë 04.04.2024 të Këshillit të Gjykatës , shkresës nr 1795/1 Prot datë 27.03.2024 të KLGJ , Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë ekzekutive, për :

1 (një) pozicion –“ Specialist i Buxhetit ” pranë Sektorit të Buxhetit dhe
Manaxhimit Financiar , kategoria IV-2.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE:

18. Prill 2024

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR:

25 Prill 2024

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin e Specilaistit të Buxhetit është:

- Merr pjesë në hartimin e kërkesave buxhetore vjetore për Gjykatën;
- Përgatit dhe propozon alokimin e burimeve dhe rishpërndarjen e të ardhurave dhe shpenzimeve, në Gjykatë;
- Përgatit materiale apo shkresat e ardhura në gjykatë apo të cilat do t'ju drejtohen të tretëve sipas porosive të eprorëve;
- Siguron përgatitjen e materialeve informuese për çështjet financiare të gjykatës dhe raportimin e tyre pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Kujdeset për monitorimin e lëvizjeve financiare të gjykatë;
- Informon në kohë dhe në formën e kërkuar për zbatimin e buxhetit dhe problematikat e mundshme, për risqet si dhe për masat që mund të merren për të adresuar këto risqe;
- Punon brenda orientimeve të dhëna nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe/ose Këshilli i Gjykatës dhe/Kryetari/Kancelari
- Siguron kontribut në vendimmarrjen e nivelit më të lartë nëpërmjet përgatitjes së të dhënave analizuese/raporteve apo çdo lloj informacioni tjetër të plotë që mbështesin linjën e rekomanduar të veprimit;
- Përdor pajisjet teknike të disponueshme si dhe sistemin e posaçëm për administrimin e buxhetit gjyqësor dhe prokurimin publik;
- Siguron përgatitjen e materialeve të duhura dhe informimin në kohë dhe në formën e kërkuar nga Shefi i Sektorit për realizimin e detyrave dhe rezultateve të arritura.
- Përgatit kërkesat buxhetore për projekt-programin buxhetor afatmesëm dhe vjetor të gjykatës duke përcaktuar nevojat për fonde, sipas natyrës së grup shpenzimeve, produkteve dhe aktiviteteve përbërëse të tyre, duke bashkërenduar punën me strukturat e tjerë të gjykatës, i paraqet për miratim në organet përkatëse (Këshillin e Gjykatës, Këshillit të Lartë Gjyqësor), brenda afateve të caktuara;
- Ndjek në vijimësi zbatimin e buxhetit të institucionit, evidenton dhe kontrollon shpenzimet buxhetore sipas zërave. Nxjerr të dhëna mujore, 6-mujore dhe vjetore, mbi bazën e dokumenteve financiare të shpenzimeve dhe të ardhurave, analizon periodikisht shpenzimet e bëra sipas zërave të buxhetit;
- Përgatit, analizon e raporton monitorimin e realizimeve financiare të gjykatës me objektivat e arritura dhe informon për ecurinë e tyre Këshillin e Gjykatës;
- Kontrollon përdorimin e fondeve që i janë dhënë gjykatës sipas destinacioneve;
- Përpunon dhe regjistron situacionet e shpenzimeve mujore të gjykatës, duke rakorduar me degën e thesarit;
- Ndjek realizimin e fondeve buxhetore korrente për Sistemin Gjyqësor dhe përgatit informacion lidhur me realizimin e tyre;
- Përgatit pasqyrat e realizimit të të ardhurave dhe pasqyrat e realizimit të shpenzimeve nga të ardhurat, në gjykatë;
- Përgatit pasqyrën e përdorimit të fondeve në valute për gjykatën dhe raporton në KLGJ dhe Ministrinë e Financave;
- Kryen detyrat të tjera duke bashkërenduar punën edhe me specialistë të tjerë të Sektorit për probleme të ndryshme, lidhur me nevoja dhe kërkesat e gjykatës për fonde shtesë, për rialokimin e fondeve, apo kur rishikohet buxheti;
- Përgatit materiale, sipas tematikës së kërkuar;

- Brenda fushës që mbulon, ndjek detyra që nuk janë parashikuar dhe çdo detyrë tjetër që ka lidhje me aspekte buxhetore dhe financiare të caktuar nga Këshilli i Gjykatës/Kryetari/Kancelari.
- Mban kontakte të vazhdueshme me homologët e tij në Gjykatat e tjera, përfaqësues të Degës së Thesarit, Drejtorisë Rajonale Tatimore përkatëse, Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të gjitha institucioneve të tjera, veçanërisht me Departamentin e Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, në KLGJ;
- Përgatitja e shkresave për KLGJ dhe institucione të tjera.

I. LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

I.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon , IV-2 (dokument nga institucioni)
- b. të mos ketë masë disiplinore në fuqi; (dokument nga institucioni)
- c. të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimi:

Të jetë diplomuar në shkenca ekonomike, niveli “Master Profesional”. Edhe nivelit “Bachelor” të jetë në shkenca ekonomike ose të barasvlershme me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit arsimit të lartë. Nëpunës civil gjyqësor, kategoria ekzekutive,

Përvoja:

Të ketë jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune në profesion (buxhet dhe financë).

Aftësi të tjera:

Njohuri të gjëra të fushës të metodave kërkimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike, aftësi për të integruar informacionin me 53 politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështjet, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën institucionale, aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.

I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dokumentat si më poshtë:

- a. Kërkësë për aplikim për vendin që konkurron
- b. Jetëshkrim i plotësuar (cv)
- c. Deklaratë mbi të dhënat e kontaktit elektronik dhe telefonik

- d. Fotokopje të noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS;
- e. Fotokopje të noterizuar librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- h. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore sipas formularit tip
- i. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- j. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- k. Akt deklarimi lidhur me statusin e nënpunësit civil gjyqësor të konfirmuar në detyrë brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon
- l. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit

Për procedurë e lëvizjes paralele kandidatët duhet të paraqesin zyrtarisht dokumentet me postë apo me e-mail në adresën e vendndodhjes së gjykatës: Lagja nr.2, Rruga “Aleksadër Goga“, Durrës, nëpërmjet shërbimit postar ose në adresën elektronike: ZMP.gjykatarrrethitdurrësdures@gjykata.gov.al brenda datës **18. 04.2024**

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

I.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **22.04.2024** Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al dhe të çdo Gjykate, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, *nëpërmjet adresës së e-mail-it*, për shkaqet e moskualifikimit.

I.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

1. Ligji nr. 98/2016 “ Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë,”;
2. Ligji nr . 96/2016 “ Për statusin e gjyqatrëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë,
3. Ligji nr. 9131 datë 08.09.2003 “ Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”;
4. Ligji nr.152/2013 “ Për nëpunësit civil”, i ndryshuar;

5. Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “ Për manaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”i ndryshuar.
6. Ligji nr 10296 datë 08.07.2010 “ Për Manaxhimin Financiar dhe Kontrollin “i ndryshuar
7. Ligji nr 8379 datë 29.07.1998 “ Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit në RSH “
8. Ligji 9228 datë 29.04.2004 “ Për kontabilitetin e pasqyrat financiare” i ndryshuar
9. Ligji 9643 datë 20.11.2006 datë 20.11.2006 “ Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij (VKM , Udhëzime etj)
10. Udhëzimi nr 30 datë 27.12.2011 “ Për manaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik “ i ndryshuar

I.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi profesional për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës sipas një sistemi pikëzimi.

Kandidatët do të vlerësohen:

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë.
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

I.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës.

II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës duke filluar nga data 25.04.2024.

II.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor janë:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimi:

Të jetë diplomuar në shkenca ekonomike, niveli “Master Profesional”. Edhe nivelit “Bachelor” të jetë në shkenca ekonomike ose të barasvlershme me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit arsimit të lartë. Nëpunës civil gjyqësor, kategoria ekzekutive,

Përvoja:

Të ketë jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune në profesion (buxhet dhe financë).

Aftësi të tjera:

Njohuri të gjëra të fushës të metodave kërkimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike, aftësi për të integruar informacionin me 53 politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështjet, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën institucionale, aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.

II.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- a. Kërkësë për aplikim për vendin që konkuron
- b. Jetëshkrim i plotësuar (cv)
- c. Deklaratë mbi të dhënat e kontaktit elektronik dhe telefonik
- d. Fotokopje të noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS;
- e. Fotokopje të noterizuar librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- h. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore sipas formularit tip
- i. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

- j. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- k. Akt deklarimi lidhur me statusin e nëpunësit civil gjyqësor të konfirmuar në detyrë brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon
- l. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit

Për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor, dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatë apo me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës: Lagja nr.2, Rruga "Aleksandër Goga", Durrës nëpërmjet shërbimit postar brenda datës **25.04.2024**

II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datë **29.04.2024**, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGJ dhe të cdo gjykate si dhe në faqen zyrtare të internetit dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim .

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

1. Ligji nr. 98/2016 " Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë,";
2. Ligji nr . 96/2016 " Për statusin e gjyqatrëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë,
3. Ligji nr. 9131 datë 08.09.2003 " Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike";
4. Ligji nr.152/2013 " Për nëpunësit civil", i ndryshuar;
5. Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për manaxhimin e sistemit buxhetor në RSH"i ndryshuar.
6. Ligji nr 10296 datë 08.07.2010 " Për Manaxhimin Financiar dhe Kontrollin "i ndryshuar
7. Ligji nr 8379 datë 29.07.1998 " Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit në RSH "
8. Ligji 9228 datë 29.04.2004 " Për kontabilitetin e pasqyrat financiare" i

ndryshuar

9. Ligji 9643 datë 20.11.2006 datë 20.11.2006 “ Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij (VKM , Udhëzime etj)
10. Udhëzimi nr 30 datë 27.12.2011 “ Për manaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik “ i ndryshuar

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- **Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.**
- **Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.**

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS**

Këshilli i Gjykatës